

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 10 MARS 2022

Për më shumë se 3 muaj është paraqitur një projektrezolutë nga 4 deputetë të opozitës: zonja Bardeli, zoti Leskaj, zoti Çela dhe unë për sa u përket tensioneve në rajonin e Ballkanit, të cilat, në një mënyrë apo një tjetër, kanë një ndikim në interesin tonë si shqiptarë dhe, për më tepër, duke e marrë në konsideruar konfliktin në Ukrainë. Ky shqetësim sa vjen dhe shtohet. E thashë edhe në seancën e fundit që ka një shqetësim të drejtpërdrejtë të Kongresit Amerikan, të Parlamentit Europian, të sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për sa u përket mundësive të tensioneve në Ballkan.

Mendoj se është jo vetëm në rëndësinë e çështjes, por edhe në rëndësinë e këtij parlamenti ta trajtojë këtë rezolutë, të bëjë ndryshimet e nevojshme, duke e sjellë në koherencë të plotë me zhvillimet, por indiferenca nuk mendoj se vlen. Ne e kemi diskutuar disa herë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e kemi në axhendë, por, për fat të keq, sot nuk kemi asnjë përgjigje nga Ministria e Jashtme apo nga grupet parlamentare, me të cilët kemi rënë dakord të paraqesim një rezolutë që na vlen për të pasur një qëndrim si parlament dhe për të kuptuar drejt edhe rëndësinë e situatës që po kalojmë.

Do t'ju lutesha, ta kalojmë sa më parë këtë rezolutë, edhe me mirëkuptimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Për mua nuk ka vlerë interesi i debatit, sa ka vlerë qëndrimi i parlamentit në raport me situatën në rajonin e Ballkanit.